

## Thirrje për propozime:

### TURIZËM MBËSHTETUR TEK TRADITAT

#### Konkurs Kombëtar Arkitekture

- 1. Pyetje :** Dokumentet që duhen për aplikim dhe projektet në çfarë teknike do të paraqiten, duke punuar në Autocad apo me dorë? Cili do të jetë trualli ku do projektohen ndërtesat e reja?

**Përgjigje:** Skicat, idetë etj të cilat në fazën e ideimit hartohen me dorë janë plotësisht të pranueshme, por gjithsesi për të qënë sa më konkurrues si në cilësi, në sasi dhe në kohë ndaj konkurrentëve të tjerë, sugjerohet që krahas skicimeve profesionale të përdoren software-et e fushës.

Si vendndodhje të propozuar për çdo zonë mund të jetë vendndodhja aktuale ose një tjetër vendndodhje e sugjeruar dhe e argumentuar nga ana e pjesëmarrësit.

2.

**Pyetje:** A lejohet pjesëmarrja në grup për një projekt ?

- Përveç kontekstit dhe tipologjive tradicionale, a do të ketë një site me konkret për propozimin?

**Përgjigje:** Propozimi duhet të jetë individual ose grup arkitektesh, po jo me shumë se tre ekspertë dhe jo kompani apo studio projektimi

Si vendndodhje të propozuar për çdo zonë mund të jetë vendndodhja aktuale ose një tjetër vendndodhje e sugjeruar dhe e argumentuar nga ana e pjesëmarrësit.

3.

**Pyetje:** Në konkurs mund të marrim pjesë vetëm me një propozim vetëm në një site (zonë) apo duhet patjetër për të tre zonat.

**Përgjigje :** Po. Vetëm një propozim vetëm për një zonë është i pranueshëm.

4.

**Pyetje:** Lidhur me konkursin "Turizëm mbështetur tek traditat", është e nevojshme të kemi një bazë hartografike. Mundet të kemi një hartë të fundit të qyteteve përkatëse, Berat, Korce, Shkoder.

Harta të ketë informacion zonifikim funksional (të cilën duhet t'a disponojnë bashkë të përkatëse). Harta mundet të jetë në format "pdf" ose "dwg". Për më tepër që se fundimi janë miratuar planet e përgjithshme të qyteteve.

**Përgjigje:** Bazën hartografike mund ta gjeni në adresën e gjeoportalit zyrtar ASIG <https://geoportal.asig.gov.al/>, mund të përdorni hartat në formatet dwg, ortofotot e

ndryshme të cilat mund ti gjeni pranë enteve të ndryshme shtetërorë si ALUIZNI, bashkitë përkatëse etj. Delegacioni nuk ofron bazë të dhënash.

5.

**Pyetje:** Propozimi që ne bejme do të jetë një propozim në një zonë të përcaktuar saktë vendodhja apo do të jetë me shumë një propozim hipotetik?

**Përgjigje:** Propozimi mund të jetë hipotetik në lidhje me qytetet përkatëse ose real në lidhje me një shesh ndërtimi të zgjedhur prej jush.

6.

**Pyetje:** Jam e paqarte përsa i përket kapacitetit të objektit (hotelit) që do të propozohet.

**Përgjigje:** Kapaciteti akomodues i banesave të reja "bed and breakfast" duhet t'i përshatet zhvillimit planimetrik dhe volumetrik të ndërtesave tradicionale të zonës. Për këtë mund t'i referoheni aneksit që ka shoqëruar shpalljen e konkursit në këtë link: [https://eeas.europa.eu/delegations/albania/34334/node/34334\\_sq](https://eeas.europa.eu/delegations/albania/34334/node/34334_sq)

7.

**Pyetje:** Kriteret e Perzgjedhjes

Duhet të paraqitet nga 1 propozim për të gjitha trevat (gjithsej 3 propozime) apo është e pranueshme të paraqitet 1 propozim vetëm për 1 trevë?

**Përgjigje:** Vetëm një propozim vetëm për një zonë është i pranueshëm.

8.

**Pyetje:** Kerkesat për projekt idente

Në lidhje me vendodhjen gjeografike është përmendur vetëm treva specifike dhe lloji i banesave karakteristike.

Lutemi një informacion nëse ka kritere të caktuara për sheshin e zgjedhur ku do propozohet objekti i ri. Gjithashtu a ka kritere të vecanta në lidhje me sheshin e ndërtimit (p.sh sipërfaqja, koeficiente, intesitet etj..)

**Përgjigje:** Vendndodhja e sugjeruar është në zonat përkatëse, ndërsa sheshi konkret i ndërtimit është zgjedhja e projektuesit. Vëllimi, përmasat e ndërtesës (sipërfaqja), numri i dhomave etj duhet të respektojnë banesat tradicionale të zonës. Qëllimi i projektit është krijimi i banesave tradicionale të cilat do të shërbejnë si "bed and breakfast". Për sa i përket intesitetit, koeficientit etj mund të referoheni dokumentave të posacëm si psh. Plani i Menaxhimit të Qendrës Historike të Qytetit të Beratit, planeve rregullues etj. Delegacioni nuk ofron bazë të dhënash.

9.

**Pyetje:** Propozimi për ndërtesa të reja që mund të përdoren për hoteleri (b&b), - është e paqarte nëse propozimi do të jetë për një apo disa objekte (psh. kompleks)?

**Përgjigje:** Nëse nga ana e pjesëmarrësit, argumentohet që në traditën e zonës kanë funksionuar dhe në të shkuarën komplekse me banesa me ndërvarësi funksionale nga njëra tjetra, dhe gjurmët e tyre janë, në ditët e sotme, të dokumentuara atëherë propozimi është i vlefshëm.

10.

**Pyetje:** a mund të propozohen ndërhyrje në objekte ekzistuese duke i adaptuar me funksionin e ri të përcaktuar?

**Përgjigje:** Po, këto projekte duhet të përbëjnë modelin e ndërtesave të reja dhe mundësisht rinovimin e atyre ekzistuese në mënyrë të qëndrueshme dhe të tillë që të mund të ruhet karakteri rajonal

11. **Pyetje:** Pjesëmarrja është e lejuar vetëm për 1 individ (arkitekt) apo mund të paraqitet një propozim i përgatitur nga një grup arkitektesh?

**Përgjigje:** Propozimi duhet të jetë individual ose grup arkitektesh, por jo më shumë se tre ekspertë dhe jo kompani apo studio projektimi

12.

**Pyetje:** Nuk kam të qartë listën e ndërtesave tradicionale ekzistuese që mund të rinovohen, konkretisht në Shkodër. Egziston një listë e tillë apo duhet personalisht secili të gjejë një objekt apo një terren specifik ku një ndërtesë me karakteristikat e përshkruara në thirrje mund të ndërtohet?!

**Përgjigje:** Listën e ndërtesave tradicionale mund ta gjeni bashkëlidhur thirrjes për projektin. Terreni i sugjeruar është në zonat përkatëse, ndërsa sheshi konkret i ndërtimit është zgjedhja e projektuesit.

13.

**Pyetje:** Vendodhja e ndërtesës së re që dua të propozoj, mund të jetë një supozim (që mund ta zgjedhë unë), apo një vend real ku mund të ndërtohet vertet?

**Përgjigje:** Vendndodhja e sugjeruar është në zonat përkatëse, ndërsa sheshi konkret i ndërtimit është zgjedhja e projektuesit.

14.

**Pyetje:** Madhësia e ndërtesës së re ka një limit? (psh. minimumi 5 dhoma, maksimumi 20 dhoma, gjatesi, gjerësi dhe lartësia, etj).

**Përgjigje:** Vëllimi, përmasat e ndërtesës, numri i dhomave etj duhet të respektojnë banesat tradicionale të zonës. Qëllimi i projektit është krijimi i banesave tradicionale të cilat do të shërbejnë si bed and breakfast

15.

**Pyetje:** Thuhet “informacion i metejshe mbi banesat tradicionale te propozuara per çdo treve dhe mbi elementet e tyre historike mund te gjenden ne aneksin bashkengjitur”, nuk gjeje material te bashkengjitur?

**Përgjigje:** Aneksi është bashkengjitur. Rivizitoni linkun e publikimit të njoftimit:

[https://eeas.europa.eu/delegations/albania/34334/node/34334\\_sq](https://eeas.europa.eu/delegations/albania/34334/node/34334_sq)

16. **Pyetje:** Eshte e nevojshme te shkruhem diku per te mare pjese ne konkurs?

**Përgjigje:** Jo, nuk ka një portal ku mund të rregjistroheni. Për të aplikuar dërgoni propozimin tuaj (PDF) në adresën: info@eun.al, si dhe kopjen e shtypur brenda datës 15.12.2017 në adresën:

*EU Info Center*

*Pallati i Kongreseve*

*Bulevardi Dëshmoret e Kombit*

*Tiranë*

17.

**Pyetje:** Funkcionaliteti

Ne titullin e konkursit thuhet qe ndertesa e re do te kryeje funksionin e nje ndertese akomodomi, d.m.th Bed and Breakfast, ndersa tek kerkesat e konkursit eshte specifikuar qe pjesa e brendshme e ndertesës duhet te respektoje funksionalitetin tradicional. Lind pyetja, si mundet qe nje ndertese te respektoje njekohesisht edhe funksionalitetin modern edhe ate tradicional? Ambientet e ndertesave tradicionale kane qene te ndara sipas funksionalitetit qe impononte koha. P.sh. shpesh, tek ndertesat tradicionale gjejmë qe kati i pare nuk ka qene i banuar pasi aty ndodheshin vetem ambientet e sherbimit, te kafsheve, te prodhimit, etj. Nje tipar tjeter dallues i ndertesave tradicionale eshte edhe ndarja e dhomave te katit te siperme sipas funksionit specifik, si p.sh ode e zjarrit - kuzhina, ode e miqve – dhoma e pritjes, çardaku – ambient ku punohej vegla dhe pune te tjera artizanale, e keshtu me radhe. Per te mos permendur pastaj faktin qe tek ndertesat tradicionale nuk ekzistonte tualeti dhe sherbimet e tjera sanitare ne kuptimin dhe rendesine qe kane sot ato per jeten moderne.

A do te kishte kuptim per nje investitor me koncepte te shendosha biznesi qe te investonte gjithë ato para per ndertuar hapsira te pashfrytezueshme ne biznesin e tij? Nese ndertesa e re do te sherbente si muze, siç eshte, p.sh. Muzeu Etnografik i Krujes, ose si qender kulturore, atehere te gjitha keto ambiente do te merrnin kuptim sepse tek to do te ekspozoheshin objekte me vlere historike e artistike. Por ne rastin e nje banese te re qe ka funksion te vetem akomodimit e udhetareve, nga kendveshtrimi financiar, çdo ambient duhet te jete i shfrytezueshem me qellim minimizimin e kostove dhe maksimizimin e fitimeve.

**Përgjigje:** Kërkesa e konkursit për ruajtjen e funksionalitetit tradicional synon respektimin e elementeve arkitekturorë të brendshëm në ndërtesa të reja bed and breakfast të cilat kanë të bëjnë me organizimin planimetrik të ambienteve, në mënyrë që njerëzit që do të akomodohen të kenë mundësinë të shohin mënyrën se si në zonën përkatëse njerëzit kanë jetuar në të shkuarën, ndërsa në të tashmen bëjnë biznes turizmi kulturor. Nëse do të referoheshim ambienteve të katit përdhe, sigurisht që ambientet nuk do të projektohen më si ambiente për kafshët apo zahire (duke maksimizuar kapacitetin hotelier), apo vendndodhja e tualeteve, por e rëndësishme për qëllimin e këtij projekti është që elementet kryesorë arkitektonikë (si cardaku, dhoma e miqve etj) të jenë prezent në mënyrë që vizitorët e akomoduar të ndiejnë prekjen e turizmit kulturor.

**18.**

**Pyetje:** Materialet e ndertimit dhe struktura

Tek lista e kerkesave ju keni vendosur qe, ashtu si ndertesat tradicionale, edhe tek ndertesat e re, materialet e ndertimit duhet te jene guri, druri dhe gelqerja, dhe keto materiale duhet te vijne ekskluzivisht nga vendburime te zones.

Ne parim ky eshte nje koncept shume i bukur qe respekton jo vetem traditen dhe origjinalitetin e ndertimit por edhe parimet me te mira nderkombetare te ndertimit te qendrueshem. Mirepo fatkeqesisht, edhe ne kete rast koncepti bie ndesh me realitetin e jetes dhe industrise moderne te ndertimit ne Shqiperi.

Nese e shikojme kete projekt edhe nje here me syte e nje investitorit te zakonshem, atehere do te verenim qe problemet me ndertimin e kesaj banese do te fillonin qe me gjetjen dhe perpunimin e materialit ndertimor. Shqiperia jo vetem qe nuk ka sot nje industri te prodhimit dhe perpunimit te drurit, por nuk kas as legjislacionin perkates per ta mbeshtetur nje aktivitet te tille, per te vetmen arsye qe edhe ato pak pyje qe i ka, rrezikohen dita-dites per tu zhdukur.

Sot, e gjithë lenda drusore për ndertim importohet nga jashtë, nga shtete, të cilat kanë burimet e nevojshme, kapacitetet dhe legjislacionin perkates per ripërteritjen e plantacioneve te lendes drusore.

Keto shtete respektojnë normat nderkombetare te shfrytezimit te lendes drusore, kane ngritur industri dhe kane zhvilluar teknologji moderne per perpunimit drurit per ndertim. Nese ne Shqiperi do te promovohet perdorimi i lendes drusore vendase per ndertim, atehere kjo do te ishte fatale per parqet dhe pyjet tona.

**Përgjigje:** Shfrytëzimi i lëndës drusore në Republikën e Shqipërisë rregullohet me ligj dhe është plotësisht e mundur që edhe sot të gjendet lëndë drusore e zonës.

**19. Pyetje:**Struktura ndertimore me mure guri e konstruksione druri perbejne gjithashtu sfida serioze teknike e financiare. Ja nga disa nga problemet kyesore qe mund te hasen nga nje investitor gjate ndertimit te kesaj godine:

Ndertimi i godinave me mure prej guri me dy flete eshte nje profesion qe nuk ushtrohet me ne Shqiperi e per pasoje specialistet e ndertimit te kesaj teknike jane shume me te rralle se specialistet e cdo lloj profesioni tjetër, per te mos thene qe jane inekzistente. Detyrimisht kjo veshtiresi teknike do te shkaktonte zvarritjen e afateve te ndertimit te godines.

**Përgjigje:**Aktualisht në tregun shqiptar të ndërtimit ka profesionistët mjaft të mirë të cilët mund të ndërtojnë me cilësi ndërtesa prej murature të pa-armuar tradicionale.

**20.**

**Pyetje:**Ndertimi i mureve prej guri me dy flete kerkon pranine e inxhinierëve dhe specialisteve teknike me eksperience ne fushen e trashëgimise kulturore, ne menyre qe te respektohen teresisht teknikat tradicionale dhe te garantohet siguria e muratures. Ky aspekt teknik do te rezultonte ne rritjen e kostove te ndertimit.

**Përgjigje:** Aktualisht në Shqipëri ka specialistë mjaft të mirë në fushën e trashëgimisë kulturore të cilët garantojnë zbatimin me korrektësi të projekteve të restaurimit, me kosto relativisht të ulët në krahasim me ndërtimet e zakonshme.

**21.**

**Pyetje:**Godinat me mure prej guri me dy flete kerkojne nje kohe shume me te gjate per tu ndertuar sesa godinat e zakonshme me beton dhe tulle qe do te thote se investitori do duhet ti pajtoje specialistet e mesiperm per nje kohe shume me te gjate se cdo duhej te bente zakonisht, gje qe gjithashtu do te rezultonte automatikisht ne rritjen e kostove te ndertimit.

**Përgjigje:**Kostoja e ndërtimit të objekteve që do të propozohen nuk është një nga kriteret e vlerësimit të projekt-ideve të konkursit. Megjithatë për sa i takon kohës së ndërtimit (edhe ky nuk është një kriter vlerësimi në këtë fazë) pa dyshim që është më e zgjatur në krahasim me teknikat e tjera të ndërtimit.

**22.**

**Pyetje:**Eksperienca me restaurimet e ndertesave historike prej guri ne vende te ndryshme te botes ka treguar qe nese nuk ndertohen me mjeshteri te larte, muret prej guri me dy flete mund te cenojne sigurine e godines dhe kjo mund te ndodhe per shkaqe nga me te ndryshme, duke filluar qe nga menaxhimi i keq i ujerave e deri tek mungesa e qendrueshmerise gjate termeteve. Tek nderteset prej guri, nje demtim sado i vogel ne muret e jashtme mund te krijoje probleme serioze ne te gjithe strukturen qe e rrethon. Kjo do te rriste ndjeshem rrezikun e shembjes se godines me kalimin e viteve.

**Përgjigje:**Qëllimi i kësaj thirrjeje për projekt-ide qëndron vetëm në projekt propozime arkitektonike, ndërsa në fazat pasardhëse patjetër që do të hartohen dhe projektet e tjera, ku përfshihet dhe projekti i shkarkimeve dhe projekti konstruktiv, të cilët garantojnë përkatësisht menaxhimin e ujërave dhe qëndrueshmërinë e objektit dhe elementeve të tij në kohë.

23.

**Pyetje:** Traret, dyshemeja dhe muret prej druri do të ishin një rrezik i vazhdueshëm zjarri për sigurinë e ndërtesës dhe të njerezve që do të qëndrojnë atje. Në mënyrë që konstruksionet të ishin vazhdimisht të mbrojtura nga zjarri, do të duhej që lenda drusore të trajtohej në mënyrë periodike me lende kundra zjarrit. Kjo do të rriste ndjeshëm kostot e mirëmbajtjes së ndërtesës në terma afatgjatë.

**Përgjigje:** Studimet tregojnë që lenda e drurit e stazhionuar dhe e trajtuar me agjentë specifike kundër zjarrit është mjaft rezistente. Gjithsesi, qëllimi i kësaj thirrjeje për projekt-ide qëndron vetëm në projekt propozime arkitektonike, ndërsa në fazat pasardhëse patjetër që do të hartohen dhe projektet e tjera, ku përfshihet dhe projekti i mbrojtjes ndaj zjarrit, i cili do të parashikojë impiante të përshtatshëm dhe sipas ligjeve në fuqi për mbrojtjen ndaj zjarrit.

24.

**Pyetje:**Druri është vazhdimisht i cenuar nga insektet dhe brejtësit. Kjo do të thotë se traret dhe të gjitha konstruksionet e tjera themelore të ndërtesës do të ishin vazhdimisht subjekt i degradimit dhe rrenimit, gjë që gjithashtu do të rriste kostot mirëmbajtjes dhe restaurimit në terma afatgjatë.

**Përgjigje:** Studimet tregojnë që lenda e drurit e stazhionuar dhe e trajtuar me agjentë specifike kundër brejtësve është mjaft rezistente dhe nga praktika restaurimi në terma afatgjatë është plotësisht i justifikuar.

25.

**Pyetje:**Tek kërkesat e renditura të konkursit ju keni shënuar që theksi duhet të vihet tek kursimi i energjisë. Mirepo druri nuk është një termoizolues i mirë. Dyshemeja dhe muret prej druri nuk e ruajnë temperaturën e ambientit në mënyrë efektive, sidomos në dimer e detyrimisht do të rrisnin jashtëzakonisht shumë kostot e menaxhimit të temperaturës. Prandaj edhe tek banesat tradicionale ekzistojnë ambientet verore me konstruksion druri dhe ambientet dimerore të vendosura tërësisht brenda strukturës prej guri.

**Përgjigje:** Studimet shkencore e rendisin drurin si një nga termoizoluesit më të mirë nga materialet e ndërtimit, veçanërisht nga ato tradicionale. Loja e cila krijohet me trashësinë e muraturës (guri ose druri) ka dhënë ndjesinë e drurit si me veti të dobëta termoizoluese. Gjithsesi, qëllimi i kësaj thirrjeje për projekt-ide qëndron vetëm në projekt propozime arkitektonike, ndërsa në fazat pasardhëse patjetër që do të hartohen dhe projektet e tjera,

ku përfshihet dhe projekti i eficeses energjitike, i cilët do të parashikojë material termoizolues të përshtatshëm sipas ligjeve në fuqi.

26.

**Pyetje:** Ndertesa me konstruksion guri dhe druri e veshtireson jashte mase zgjerimin e nderteses ose riorganizimin e mabjenteve te brendshme ne te ardhmen. Nese nje investitor e gjykon te nevojshme qe te zgjeroje ose riorganizoje aktivitetin e tij, atehere konstruksioni nuk duhet ti behet pengese per kete gje. Cilido investitor do te ishte shume me i prirur qe te ndertonte nje banese me tipare tradicionale nese ajo do ti pershtatej leshtesisht kushteve te funksionalitetit dhe jeteses moderne.

**Përgjigje:** Është e vërtetë që në ndërtesat me konstruksion guri, mundësia e zgjerimit është e vogël, por qëllimi i këtij projekti nuk do të jetë krijimi i ndërtesave me mundësi zgjerimi në të ardhmen, por objekteve me karakteristika tradicionale, në zona mjaft të mbrojtura nga pikëpamja e trashëgimisë kulturore.

27.

**Pyetje:** Disa ceshtje te tjera disi te paqarta ne lidhje me projektimin e kesaj ndertese jane aspekte te tilla teknike si terreni gjeografik ku do te ndertohej kjo banese (koder ose fushe), mjedisi (urban apo fshati), numri i dhomave te fjetjes, siperfaqja e ndertimit, etj. Banesat tradicionale nder shekuj u jane nenshtruar ketyre kushteve ambjentale kudo qe ato jane ndertuar. Besoj, e njejta gje duhet te jete edhe per ndertesen ne fjale.

**Përgjigje:** Vendndodhja do të propozohet nga ana e konkurrentit, megjithatë zonat e rekomanduara janë ato ku banesat tradicionale janë sot të lokalizuara (duhet të kihet parasysh topografia fushore e zonës së qytetit të Shkodrës, ajo e pjerrët e qytetit të Beratit dhe ajo e fshatit Dardhë).

Kapaciteti akomodues i banesave të reja bed and breakfast duhet t'i përshtatet zhvillimit planimetrik dhe volumetrik të ndërtesave tradicionale të zonës. Për këtë mund t'i referoheni aneksit që ka shoqëruar shpalljen e konkursit. Ndaj, vëllimi, përmasat e ndërtesës (sipërfaqja), numri i dhomave etj duhet të respektojnë banesat tradicionale të zonës, pa kufizuar megjithatë zgjidhje ose qasje të reja ndaj organizimit apo materialeve kryesisht në interior të cilat nuk çënojnë elementet identifikues të banesave popullore dhe madje mund t'i theksojnë ato. Qëllimi i projektit është krijimi i banesave si ato tradicionale të cilat do të shërbejnë si bed and breakfast për turistët. Për sa i përket adaptimit në kushtet e reja, theksojmë se një nga kriteret e restaurimit por edhe të ndërtimit në zona të mbrojtura nga pikëpamja e trashëgimisë kulturore është identiteti dhe në këtë kontekst nuk është e këshillueshme që projekt-propozimet të reflektojnë kërkesat për turizëm të ndryshëm nga ai tradicional.

28.



**Pyetje:** Parcelat e propozimeve ne qytetet e caktuara, do te zgjidhen nga ne apo do te jepen nga organizatoret?

**Përgjigje:** Parcelat e propozimeve do të zgjidhen nga ana e projektuesve.

29.

**Pyetje:** Kompozimi i eksterierit, sipas kerkesave te konkursit, rezulton po ajo e ndertesave tradicionale. Kjo fasade do permbaje elemente novatore, apo do vazhdoje te jete ajo tradicionale? Lejohet perdorimi I materialeve te reja, pervec tradicionale(psh: xham ose metal)?

**Përgjigje:** Në parim, fasadat, volumet dhe zhvillimi planimetrik duhet të ndjekin traditën historike të zonës. Megjithatë, nëse gjykohet se futja e ndonjë elementi novator nuk cënon nga ana estetike peisazhin historik dhe si dhe reflekton eksperiencën aktuale të fituar nga ndërtuesit e zonës, mund të pranohet si propozim.

30.

**Pyetje:** Eshte vene ne dispozicion nje formular aplikimi apo regjistrimi behet me ane te e-malit?

**Përgjigje:** Aplikimi do të kryhet me anë të email-it brenda përfundimit të orarit zyrtar të punës, më 15 Dhjetor 2017, sikurse kopja e ngurtë (hardcopy) e projektit duhet të dorëzohet në adresën

*EU Info Center*

*Pallati i Kongreseve*

*Bulevardi Dëshmoret e Kombit*

*Tiranë*

31.

**Pyetje:** Ndertesa e propozuar ne cdo si interieri apo eksterieri, do te jete identike me tradicionalen, pra kopje?

**Përgjigje:** Projekt-ideja nuk duhet të jetë kopje e ndërtesave ekzistuese, por elementet kryesorë që identifikojnë këto banesa duhet të ruhen. Pra projektuesit, kanë lirshmëri në zgjidhje të reja funksionale të interierit, impiantet teknologjike, ekologjike etj.

32.

**Pyetje:** Kerkohet preventiv mbi projektin?

**Përgjigje:** Në këtë fazë, nuk kërkohet preventiv.

33.

**Pyetje:** Proporcionet ne fasade, duhet te jene identike me ato tradicionale?

**Përgjigje:** Proporcionet e fasadave dhe volumet e ndërtesave në tërësi duhet të ruhen, pasi në të kundërt krijojnë kontrast të padëshiruar me pjesën historike të zonave dhe traditën qindrvajecare të ndërtimit në këto zona.

34.

**Pyetje:** Mundet të kemi me shume të dhena për hapësirën e parcelës ku do të projektohet? A duhet të merren parasysh pjerresitë të mundshme të terrenit? (këtu referohet për Beratin duke pasur parasysh karakterin gjeografik)

**Përgjigje:** Hapsira e parcelës do të zgjidhet nga ana e konkurrentit. Patjetër që për Beratin do të merret parasysh terreni i pjerrët, i cili ka pasur rol vendimtar në zhvillimin e banesës së kësaj zone.

35.

**Pyetje:** Sa është max i sipërfaqes së projektimit? Zgjidhjet planimetrike jo detyrimisht do i përshtaten strukturës së dy apo tre kthinave duke pasur parasysh karakterin e shfrytëzimit hotelier.

**Përgjigje:** Kapaciteti i akomodimit i banesave të reja bed and breakfast duhet t'i përshtatet zhvillimit planimetrik dhe volumetrik të ndërtesave tradicionale të zonës. Për këtë mund t'i referoheni aneksis që ka shoqëruar shpalljen e konkursit. Ndaj, vëllimi, përmasat e ndërtesës (sipërfaqja), numri i dhomave etj duhet të respektojnë banesat tradicionale të zonës, pa kufizuar megjithatë zgjidhje ose qasje të reja ndaj organizimit apo materialeve kryesisht në interior të cilat nuk çenojnë elementet identifikuese të banesave popullore dhe madje mund t'i theksojnë ato. Qëllimi i projektit është krijimi i banesave si ato tradicionale të cilat do të shërbejnë si bed and breakfast për turistët.

36.

**Pyetje:** Duke mos pasur një shesh konkret për të pozicionuar objektin veshitësohen disa faza të projektimit dhe zgjidhjet përkatëse të orientimit kundrejt situatës aktuale, pozicionimi kundrejt rrugëve, hyrje-daljeve, orientimet përkatëse etj.

**Përgjigje:** Pozicionimi i objektit kundrejt orientimit të objektit, rrugëve, hyrje-daljeve është zgjedhje e projektuesit, dhe nuk duhet harruar më tepër rëndësi do t'i kushtohet qëllimit të kësaj thirrjeje për projekt ide e cila është dhënia e ideve për ndërtesa të reja bed and breakfast me karakteristika arkitekturore popullore të zonave përkatëse, për të inkurajuar ndërtimin e objekteve të rinj me qëllim turistik duke sjellë qasje të reja në planifikimin e turizmit arkitekturor të zonës, pejsazh dhe interiorin e objekteve.

37.

**Pyetje:** Pyetja ime lidhet me mënyrën e prezantimit (Layout):

Kerkoheq qe cdo pjesemarres te paraqes propozimin ne Format A3 por ne fund thuhet se propozimi duhet te paraqitet ne maksimumi 4 skica Format A0. A do te thote kjo se Layout duhet ne Format A0 por per lehtësi dergimi me post elektronike te jete e konvertuar ne Format A3?

**Përgjigje:** Jo, mënyra e kërkuar e paraqitjes nuk ka të bëjë me lehtësinë e dërgimit me anë të postës elektronike. Projekti arkitektonik duhet të jete i formatuar në formatin A3, relacionet teknike përshkrimore në formatin A4, ndërsa paraqitja e propozimit në formatin A0, qoftë në version elektronik, qoftë në atë në letër. Propozimi i projektit në formatin A0 do të shërbejë për prezantimin e shkurtuar dhe elementet kryesorë të tij në ditën kur juria do të vlerësojë projekt-identetë. Megjithatë, kjo nuk nënkupton që juria do të kryejë vlerësimin vetëm mbi posterat A0, pasi është projekti në tërësi që do të vlerësohet, përfshirë analizën historike, etnografike, të gjendjes aktuale, pritshmëritë e secilit propozim etj.

**38.**

**Pyetje:** Doja te dija nese Projekt propozimet qe duhen paraqitur kane per qellim vetem perdorimin e tyre per hoteleri apo mund te perdoren edhe per qellime te tjera? Me shume jam e interesuar te di nese mund te rikonstruojme ndertesat ekzistuese qe me pare nuk kane pasur funksion te tyre hotelerine, kryesisht kullat e vjetra popullore shqiptare te cilat ndodhen ne zonat kodrinore e malore te ketyre trevave e jo brenda ne qytet. Keto ndertesat kane nje arkitekture, forme ndertimi, por mbi te gjitha, historine, dramet dhe gezimet e popullit Shqiptar. Kullat e mocme kane arkitekturen e tyre tipike, tavanet e gdhendura, qoshet e kullës, oxhaket, qemeret e derës, mullinjte e blojes, te fundit relike te nje kohe te shkuar, punishtet tradicionale, toponomine tradicionale, gjithcka nga memoria historike. Mund te permend Kullen e Nikaj Merturit. Gjithashtu ne Berat do te permendja ethnographic museum, eshte nje objekt me vlera historike e qe duhet ruajtur ne kohe por besoj se nje rikonstruktim i ketij objekti do ishte i nevojshem per ta paraqitur si nje objekt turistik me vlera te vyera historike.

**Përgjigje:** Jo, qëllimi i këtij projekti është krijimi i objekteve të reja të tipit bed and breakfast, të cilat duhet të kenë karakteristika arkitekturore të ngjashme me banesat tradicionale të zonave përkatëse. Meqënëse këto zona, në një pjesë të mirë të tyre janë dhe zona të mbrojtura në kontekstin historiko-monumental cdo propozim për ndërtesa të reja duhet të jetë mjaft i kujdesshëm dhe të respektojë vetëm peisazhin por dhe ligjet e rregulloret në fuqi.

**39.**

**Pyetje:** Kerkoheq nje riorganizim i brendshem i strukturave tradicionale, qe te plotesojne kushte pritese hotelerie?

**Përgjigje:** Pjesëmarrësit kanë të drejtë të japin variantet e tyre të ri-organizmit të brendshëm të strukturave tradicionale në mënyrë që të plotësojnë kushte pritëse hotelerie, por ama është e rëndësishme që në këtë riorganizim të mos humbasë fryma popullore e funksionimit të banesës si njësi mikpritëse, pra më tepër të ndihen të mikpritur në një banesë tradicionale se në një mini-hotel konvencional.

40.

**Pyetje:** A lejohet një update ose shkrije sado e vogël me frymen moderniste në hapësirën e brendshme (interier), në mënyrë që të evidentohen edhe me shumë detaje të brendshme të tradicionales nëpërmjet kontrastit?

**Përgjigje:** Po, nëse ky up-date apo shkrijë në interier me frymën moderniste është racionalë,.

41.

**Pyetje:** Duhet regjistrim paraprak, apo bëhet automatikisht në momentin e dorëzimit të projektpropozimit?

**Përgjigje:** Jo, nuk është i nevojshëm një regjistrim paraprak. E rëndësishme është që projekti të dorëzohet në formatin e kërkuar dhe brenda afatit.

42.

**Pyetje :** Skicat format A0 duhet të trajtohen në formë posterash? Si edhe në çfarë materiali duhen printuar (karton, forex, etj)?

**Përgjigje:** Po, materiali që do të dorëzohet në format A0 do të shëbejë për prezantimin e përmbledhur të projekt-idesë tuaj. Materiali ku do të printohet është në zgjedhjen tuaj dhe nuk do të ndikojë në përzgjedhjen cilësore të projektit.

43.

**Pyetje:** Ka ndonjë program për projektimin ose referencë në lidhje me madhësinë e objektit, numrin e dhomave, personave ose kushte të tjera të ngjashme, gjithashtu nëse duhet projektuar thjesht një ndërtesë tip apo duke marrë parasysh ndonjë kontekst urban me specifik.

**Përgjigje:** Referencat për banesat tradicionale mund t'i gjeni në aneksin bashkëlidhur shpalljes së konkursit.

44.

**Pyetje:** Materiali digital duhet të jetë i formatuar në A3?

**Përgjigje:** Projekti arkitektonik duhet të jetë i formatuar në formatin A3, relacioni teknik përshkrimor në formatin A4, ndërsa paraqitja e propozimit në formatin A0.

45.

**Pyetje:** Po materiali i printuar, edhe ai duhet te jete po i printuar ne format A3, me perjashtim te raportit lidhur mne analizen historike dhe te specifikimeve teknike, te cilat duhet te jene ne A4?

**Përgjigje:** Po, edhe materiali i printuar duhet të plotësojë të njëjta kërkesa sikurse materiali elektronik.

46. **Pyetje:**Ne piken e fundit gjithashtu thuhet shprehimisht: "Maksimumi 4 skica (format A0) ku të paraqitet i gjithë propozimi."

-Kjo nenkupton dorezimin e te gjithë projektit te permbledhur ne jo me shume se 4 "skica" ( p.sh: besoj nenkupton ne kete rast planimetri, pamje, detaje dhe pamje 3d), edhe ne format A0, pra te grupuar ne llogjiken e nje posterit A0 ku prezantohet permbledhtas projektin?

**Përgjigje:**E saktë, propozimi i projektit do të shërbejë për prezantimin e shkurtuar dhe elementet kryesore të tij në ditën kur juria do të vlerësojë projekt-identetë. Megjithatë, kjo nuk nënkupton që juria do të kryejë vlerësimin vetëm mbi posterat A0, pasi është projektin në tërësi që do të vlerësohet, përfshirë analizën historike, etnografike, të gjendjes aktuale, pritshmëritë e secilit propozim etj.

47.

**Pyetje:**Lidhur me vendodhjen e projektit, a ka nje planvendosje konkrete?

**Përgjigje:** Jo, planvendosja do të propozohet nga ana e konkurrentit, megjithatë zonat e rekomanduara janë ato ku banesat tradicionale janë sot të lokalizuara.

48.

**Pyetje:**Po pervec materialit te bashkangjitur ne aneksin e njoftimit, a ka materiale te tjera, grafikisht me te pasura dhe me te qarta ku te lexohen indormacionet e nevojshme teknike te planimetrive te ndertesave tip? Po materiale digitale te tjera te nevojshme?

**Përgjigje:** Delegacioni nuk ofron bazë të dhënash.

49.

**Pyetje:** Doja nje informacion nese puna mund te propozohet nga nje grup (prej 3-4 arkitektesh) ?

**Përgjigje:**Propozimi mund te jete prej nje grupi prej 2 deri ne 3 persona. Studiot e arkitektures nuk lejohen te aplikojne ne kete konkurs.

50.

**Pyetje:** Jam shumë e interesuar për te marre pjese ne kete konkurs, por doja te pyesja, po shtepite karakteristike te Permetit perfshihen ne fokusin e ketij konkursi?

**Përgjigje:** Jo shtepitë e Përmetit nuk përfshihen në fokusin e këtij konkursi. Vetëm trevat e listuara në thirrjen për propozime janë të përfshira

51.

**Pyetje:**Jemi nje grup arkitektesh nga Kosova, qe do donim te konkurojme ne konkursi ne shpallur nga ju. Por paraparakisht deshtem te informohemi nese mund te marrim pjese si grup nga Kosova, apo eshte e lejuar vetem per shtetas te Shqiperise. Gjithashtu projektet a duhet te dorezohen fizikisht apo ben vetem edhe si kopje digjitale.

**Përgjigje:** Po mund të merrni pjesë në konkurs. Për dorëzimin e projekteve ju lutem ndiqni informacionin e dhënë në këtë link

[:https://eeas.europa.eu/delegations/albania/34334/node/34334\\_sq](https://eeas.europa.eu/delegations/albania/34334/node/34334_sq)

52.

**Pyetje:**Une nuk jam arkitekt por gdhendes druri, dhe mendoj per dizenjimin e brendshem duke qene se banesat tradicionale kane disa korniza druri dhe rozeta dhe elemente te tjere te gdhendjes qe jane karakteristike ne keto ndertesa. Me thoni ju lutem a mund te aplikoj ne konkurs vetem me dizenjimin dhe vizatimin e ketyre elementeve?

**Përgjigje:** Jo nuk mund të aplikoni pasi nuk përmbushen kriteret. Për më tepër ju lutem referojuni informacioni në këtë link :

[https://eeas.europa.eu/delegations/albania/34334/node/34334\\_sq](https://eeas.europa.eu/delegations/albania/34334/node/34334_sq)

53.

**Pyetje:** Propozimi (ne rastin e struktures se re) duhet te jete nje grumbull ndertimesh. Nje ndertese e vetme, apo ka ndonje kufizim per sa i perket siperfaqes se objektit (objekteve)

**Përgjigje:** Propozimi duhet të jetë vetëm për një ndërtesë. Nuk ka një zonë të përcaktuar, por parashikohet të respektohet legjislacioni në fuqi për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore.

54.

**Pyetje:** A do te kete ndihma te tjera nga organizata juaj, psh per fituesin per realizimin e projektit, apo do të mbetet ne kufinje e projekt idesë.

**Përgjigje :**Kjo do të përcaktohet në të ardhmen.